



---

**RAPORT**  
**KORRIK – DHJETOR**  
**2023**

---

**\*Ky raport përmbledh veprimtarinë e kryer nga institucioni gjatë periudhës Korrik-Dhjetor 2023.**

## **PËRMBAJTJA**

---

SHKURTESA	3
1. HYRJE	4
2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	5
2. ZBATIMI I PLANIT TË RI-INTEGRIMIT	9
3. AKTIVITETE INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE RRYTJA E KAPACITETEVE	17
4. KOMUNIKIMI STRATEGJIK	22
5. BASHKËPUNIME ME PARTNERË NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL, NDËRKOMBËTAR	23
6. AKTIVITETI RAPORTUES DHE MONITORUES	31
7. PROBLEMATIKA	28



## 1. SHKURTESA

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	QKEDH
Parandalimi dhe Kundërshtimi i Ekstremizmit të Dhunshëm	P/KEDH
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	MSHMS
Ministria e Brendshme	MB
Ministria e Mbrojtjes	MM
Ministria e Drejtësisë	MD
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	MPEJ
Ministria e Arsimit dhe Sportit	MAS
Organizata Ndërkombëtare për Migracionin	IOM
Fondi Global i Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë të Komunitetit	GCERF
Komisioni Evropian	KE
Rehabilitimi, Ri- integrimi dhe Risocializim	RRR
Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social	IANS
Gender Alliance for Development Center	GADC
Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive	AKPA
Vendim i Këshillit të Ministrave	VKM
Luftëtarëve të Huaj Terroristë	LHT
Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve	DPB
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	AKSHI
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim	IDM
Organizata të Shoqërisë Civile	OSHC
Drejtoria Antiterrorit	DA
Shërbimi Informativ i Shtetit	SHISH
Njësia Administrative	NJA
Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës	PMF
Terres de Homme	TdH
Woman Center for Development and Culture Albania	WCDCA
Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza	LKGV
Tirana Legal Aid Society	TLAS
Zyra Vendore Arsimore	ZVA
Grupi Teknik Ndersektorial	GTN



## 2. HYRJE

Ky raport ka për qëllim të përmbledhë aktivitetin e periudhës gjashtë mujore korrik- dhjetor 2023 të Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe është hartuar duke evidentuar aktivitetet e kryera bazuar në objektivat institucionale.

Kundërshtimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm është një sfidë komplekse që kërkon një qasje të integruar dhe afatgjate nga qeveritë vendore, komuniteti ndërkombëtar, organizatat shoqërore dhe individët, ndaj në vazhdim ky dokument do të paraqesë të gjitha aktivitetet lidhur me parandalimin dhe kundërshtimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet krijimit dhe reformimit të komuniteteve dhe institucioneve më të qëndrueshme, rehabilitimin-riintegrimin dhe risocializimin e personave që shfaqin shenja apo elementë të radikalizimit si dhe individët e rikthyer nga zonat e konfliktit dhe familjeve të tyre, zhvillimin e një komunikimi strategjik dhe parandalimin e kundërshtimit të radikalizimit online.

QKEDH është institucioni kryesor i cili realizon dhe mbikëqyr projekte, aktivitete të iniciuara nga vetë qendra apo në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore dhe/ose lokale, apo të iniciuara nga palët e treta/ shoqëria civile në kuadër realizimit të iniciativave për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe të ri-integrimit të shtetasve të rikthyer nga zonat e konfliktit (Siri, Irak).

Prej ngritjes së QKEDH në vitin 2018, Qeveria Shqiptare ka investuar në identifikimin, adresimin dhe trajtimin e fenomeneve të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në nivel qendror dhe vendor. Në periudhën raportuese, aktiviteti QKEDH-se është përqendruar në zbatimin e veprimtarisë së planifikuar në nivel qendror dhe vendor në bashkëpunim me partnerë/aktorë të ndryshëm të shoqërisë për përmbushjen e objektivave të Planit të Veprimit (P/KEDH) në parandalimin e fenomenit.

QKEDH ka vijuar realizimin e misionit të saj koordinues ndër-institucional në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm në zbatim të **Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025** si dhe Planin e Veprimit 2023-2025 të miratuar me VKM Nr.81, date 14.02.2023, si dhe Planin e Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor për vitet 2023-2024 si detyrim i vendit për përmbushjen e prioriteteve të përcaktuara për të luftuar terrorizmin me të gjitha format e shfaqjes së tij, si dhe nevoja e implementimit të objektivave që dilnin nga detyrimet ndërkombëtare të miratuara nga Këshilli i Sigurisë i OKB-së, Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit dhe Konventën Evropiane dhe Protokollin shtesë të saj për parandalimin e terrorizmit, ku adresohet edhe fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë (LHT).



### **3. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

Ky raport ka për qëllim të përmbledhë aktivitetin e periudhës raportuese 6-mujore korrik- dhjetor 2023 të QKEDH dhe është hartuar duke evidentuar aktivitetet e kryera bazuar në objektivat institucionale.

QKEDH në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku” dhe VKM nr. 237 dt. 20/04/2022 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 737 dt. 13/12/2017 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, QKEDH vazhdon angazhimin për koordinimin dhe monitorimin e punës me institucionet qendrore, vendore dhe partnerët ndërkombëtarë për proceset e parandalimit të radikalizmit, kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe pritjes dhe akomodimit të shtetasve të rikthyer nga zonat e konfliktit si dhe zbatimit të planeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit. Ka vijuar zbatimi dhe monitorimi i procesit të ri-integrimit të 37(tridhjetë e shtatë) personave të riatdhesuar nga këto kampe, konkretisht për 13 (trembëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datë **27 maj 2022**, 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë të riatdhesuar më datën **1 gusht 2021** dhe 5(pesë) shtetasve shqiptarë të riatdhesuar në **27 tetor 2020** si dhe realizimin e objektivave të Planit të Veprimit P/KEDH.

Qendra udhëheq dhe orienton përpjekjet e institucioneve shtetërore për të zbatuar **Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Planit të Veprimit 2023-2025**, si dokumenti më i rëndësishëm për t’u zbatuar në këtë drejtim, si dhe procesit të rehabilitimit, riintegritit dhe risocializimit të të gjithë shtetasve të riatdhesuar gjatë tre misioneve të riatdhesimit dhe atyre që pritet të rikthehen në vijim. Ky aktivitet përfshin:

- ⇒ Zbatimin e e masave për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm bazuar Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Planit të Veprimit 2023-2025;
- ⇒ Koordinimin dhe bashkërendimin e të gjithë strukturave shtetërore dhe organizatave të përfshira për riintegrimin dhe risocializimin në komunitet të 37 (tridhjetë e shtatë) shtetasve të rikthyer, konkretisht, 28 (njëzet e tetë) fëmijë dhe 9(nëntë) gra, si dhe atyre që pritet të rikthehen;
- ⇒ Promovimin dhe mbështetjen e rolit të shoqërisë civile në zbatimin e plotë të veprimit të P/KEDH-së në koordinim me institucionet e linjës;
- ⇒ Koordinimin e punës dhe orientimin e partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, mbështetës të procesit të rehabilitimit, ri-integrimit dhe të risocializimit (RRR) të shtetasve të kthyer;
- ⇒ Nxitjen e kontributit me ide–propozimet e kërkuara QKEDH-së, në kuadër të zbatimit të P/KEDH me qëllim tërheqjen e granteve të vogla të publikuara nga donatorët mbështetës të Qeverisë Shqiptare në fushën e P/KEDH; (Ref. OSHC-ve, lidhur me grantet e akorduara nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, etj.);



⇒ Mbështetjen dhe promovimin e OSHC-ve shqiptare në kuadër të idesë së partneritetit publik-privat me qëllim forcimin e rolit të tyre, por edhe thithjen e fondeve të akorduara nga organizata ndërkombëtare GCERF, me qëllim kontributin dhe impenjimin e OSHC-ve për të përfutur mbështetje të konsiderueshme ndërkombëtare në kuadër të objektivave dhe zbatimit të aktiviteteve të P/KEDH në Shqipëri.

Përgjatë periudhës raportuese, QKEDH vijon punën për implementimin e Planit të Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor, ku janë përcaktuar masat prioritare të QKEDH për vitet 2023-2024 në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit.

Në përmbushje të objektivave të Planit të Veprimit, QKEDH ka koordinuar dhe ka marrë pjesë në 167 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) sesione trajnimi/forume/takime informuese/workshop/webinare online dhe bashkëpunime për ngritje kapacitetesh për strukturat e përfshira drejtpërdrejtë dhe trajnime si në nivelin qendror, ashtu dhe në nivelin vendor të lidhura me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe procesin e ri-integrimit; ka vazhduar puna për vizibilitetin e aktivitetit të institucionit duke kryer rregullisht publikimin e këtij aktiviteti në faqen zyrtare WEB, rrjetin social Twiter dhe në Linked-in.

Në vijim të zbatimit të planit të veprimit, QKEDH ka përcjellë për miratim pranë Ministrisë të Brendshme **“Procedurën Standarde të Veprimit”** për rehabilitimin dhe riintegrimin fillestar të personave të kthyer nga zonat e konfliktit Siri-Irak të draftuar nga QKEDH dhe rishikuar nga të gjitha institucionet përkatëse. Ky dokument standard veprimi, është hartuar në kuadër të përgjegjësisë së saj për koordinimin ndër-institucional me partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë, mbështetjen e institucioneve vendase si edhe monitorimin e vazhdueshëm të të gjithë procesit të kthimit dhe riadhesimit të shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak<sup>1</sup>.

**QKEDH i ka dhënë një peshë të veçantë bashkëpunimit të shkëlqyer me partnerët kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë.** Në kuadër të bashkëpunimit me partneri strategjik GCERF, përmes të cilit zbatohen programet e Rehabilitimit dhe Ri-integrimit për shtetasit e rikthyer nga ish zonat e konfliktit, Siri dhe Irak, për familjet e tyre dhe komunitetin e gjerë në Shqipëri. Në cilësinë e shtetit partner në Ballkanin Perëndimor, pjesë e Bordit Drejtues të GCERF që është Shqipëria pas identifikimit të saj si një shtet me një institucion të cilësuar si model në parandalimin e radikalizmit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm, ka krijuar një Mekanizëm Teknik të Mbështetjes së GCERF ku marrin pjesë palë të interesuara të përzgjedhura dhe me përvojë në projekte për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Mekanizmi përfshiu partnerë nga institucione shtetërore, donatorë ndërkombëtarë të cilët operojnë në Shqipëri, organizata ndërkombëtare, bota akademike, dhe sektori privat.

---

<sup>1</sup> VKM Nr. 826, datë 26.10.2020;



Mekanizmi Teknik i Mbështetjes ka funksionuar **si një tryezë konsultuese** ku palët janë shprehur rreth objektivave të përgjithshëm, nevojave dhe projekteve konkrete, linjës së vizionit që GCERF do të synojë në mbështetjen financiare të ofruar. Gjatë muajit nëntor u mbajt takimi i drejtuar nga zv. Ministria e Brendshme me përfaqësues nga GCERF dhe grupit ndërinstitucional të Mekanizmit Teknik të Mbështetjes së projekteve. Në këtë takim u prezantua Strategjia e Investimit për periudhën 2024-2027, e cila synon të adresojë sfidat e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në shoqërinë tonë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të GCERF, delegacionit të BE në Shqipëri, përfaqësues të ambasadave si dhe përfaqësues të institucioneve të përfshira në përpjekjet për P/KEDH si dhe shoqërisë civile, të cilët diskutuan strategjinë dhe rolin e tyre në zbatimin e saj. Strategjia përfshin një qasje gjithëpërfshirëse dhe multisfere, duke angazhuar jo vetëm institucionet qeveritare por edhe shoqërinë civile, me qëllim koordinimin e përpjekjeve dhe forcimin e kapaciteteve për të luftuar këto fenomene sociale.

Në vijim të Mekanizmit Teknik të Mbështetjes dhe me ndihmën e GCERF nëpërmjet oraganizatës PVN-Albania u realizua vlerësimi i nevojave në nivel kombëtar në Shqipëri. Grupi i punës përdori një metodologji mikse të të dhënave kualitative dhe kuantitative për të analizuar ekstremizmin e dhunshëm dhe për të vlerësuar mundësitë afatgjata të parandalimit dhe ri-integrimit (R&R) të të rikthyerve. Hulumtimi u udhëhoq nga tre pyetje kryesore: 1- Faktorët dhe Format e Ekstremizmit të Dhunshëm: 2- Mekanizmat për Parandalimin dhe Lehtësimin si dhe 3- Perceptimi i Komunitetit dhe Praktikrat e Mira.

Metodologjia e vlerësimit të nevojave përfshiu kërkimet kabinetike për të kuptuar situatën politike dhe kontekstin institucional për identifikimin e formave të ekstremizmit dhe mënyrat e parandalimit të tij, 30 intervista me aktorë të përfshirë në P/CVE si dhe aktorët e vijës së parë, 5 fokus grupe që përfshijnë mësuesit, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe psikologët. Gjithashtu një tjetër metodologji e përdorur është grumbullimi i të dhënave kuantitative përmes sondazheve për të kuptuar aspektet dhe faktorët që çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm, shqetësimet e komunitetit lidhur me sigurinë, si dhe perceptimet e anëtarëve të familjeve të personave të rikthyer nga zonat e konfliktit.

Gjithashtu, me mbështetjen e GCERF, po vijon përpjekjet për implementimin e propozimit të QKEDH mbi ngritjen e një qendre multidisiplinore në Tiranë për ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjet viktimë të ekstremizmit të dhunshëm.

Një aspekt shumë i rëndësishëm për realizimin e misionit të QKEDH-se është miratimi i **Urdhrit të Kryeministrit “Për ngritjen dhe funksionimin e Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizmit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm”, me Nr.185, datë 31.10.2023.** Ky urdhër do të shërbejë si mekanizëm kombëtar referimi, pasi deri më tani një mekanizëm i tillë mungonte duke sjellë vështirësi dhe pamundësi të evidentimit të rasteve dhe fenomeneve radikale në kohën e duhur. Ky mekanizëm do të udhëhiqet nga 12 prefektët e qarqeve nën koordinimin dhe monitorim e drejtorit të QKEDH.



Nëpërmjet organizatës Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, në kuadër të projektit të financuar nga GCERF kanë nisur përpjekjet për ndërtimin e një Mekanizmi Kombëtar Referimi për çeshtjet e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Rehabilitimit të të Rikthyerve, një ndërhyrje e cila do të implementohet fillimisht në 20 bashki pilot të vendit. Ngritja e një Mekanizmi Kombëtar për Ekstremizmin e Dhunshëm është në të njëjtën linjë me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 185 datë 31.10.2023 “Për ngritjen dhe funksionimin e komiteteve rajonale të parandalimit të radikalizmit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm”.

Në kuadër të ngritjes së sistemit të bazës së të dhënave për menaxhimin e informacionit (sistemi ICERS), databazë elektronike për personat e kthyer nga ish zonat e konfliktit Siri dhe Irak, ka përfunduar faza e vlerësimit teknik si dhe atij ligjor. QKEDH-ja është koordinuar me Komisionerin për Mbrojtjen e të dhënave si dhe AKSHI-n, në çdo fazë të përpilimit të këtij sistemi. Parashikohet që ky sistem, i cili është mbështetur nga organizata IOM, të implementohet në 6-mujorin e ardhshëm. Sektori i sigurise update.

Përgjatë gjithë periudhës korrik-dhjetor 2023, puna e QKEDH është fokusuar në koordinim me PMF-të e Njësive Administrative përkatëse, psikologët dhe përfaqësues të Shërbimit Ligjor, i cili jepet nga organizata TLAS, Drejtorisë së Antiterrorit dhe strukturave të Policimit në Komunitet, Rrjetin e Mësuesve Koordinatorë në nivel Kombëtar si dhe Organizatat e Shoqërisë Civile. Ka identifikuar dhe bashkërenduar punën për trajtimin e dy çështjeve që lidhen me radikalizmin, ekstremizmin e dhunshëm si dhe shfaqjen e fenomeneve të reja që janë hasur te personat e rikthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak, si në fazën e rehabilitimit ashtu edhe në atë të riintegritimit në komunitet.

Në lidhje me ndërhyrjet në sistemin e burgjeve, QKEDH nëpërmjet oraganizatës LKGV synon krijimin e *një instrumenti të dedikuar për të dënuarit për ekstremizëm të dhunshëm me qëllim zhvillimin e një qasje të personalizuar për metodologjinë e rehabilitimit dhe rinteprimit*. Në lidhje me këte, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar takime me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrinë e Drejtësisë për t’u njohur me ndërhyrjet ekzistuese në burgje dhe hartuar një metodologji e cila forcon ndërhyrjet e deritanishme, kryesisht të realizuara nga KE dhe shmang dublikimet. Qëllimi primar është të krijojë një instrument të dedikuar për rehabilitimin dhe riintegritimin e të dënuarve, duke u mbështetur në një analizë të karakteristikave të tyre, nevojave, Pproblematikave si dhe sfidave që hasin të dënuarit në burgje.

Në kuadër të prioritetit që Qeveria Shqiptare do t’i sigurojë QKEDH financim, staf dhe mbështetje të mjaftueshme politike për të kryer detyrat e saj në mënyrë efektive dhe me standarde të larta profesionalizmi, pas hartimit të projektvendimit “**Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit (AKTE)**” dhe konsultimit me ministrinë e linjës dhe institucionet që kanë fushë veprimi mbi EDH, jemi në procesin final të miratimit të këtij akti i cili do të jetë pranë Kryeministrit; ndërkohë prej dhjetorit 2023 buxheti i qendrës ka kaluar pranë Kryeministrisë.

QKEDH ka nxitur angazhimin e institucioneve kompetente shtetërore dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore, rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe aksesueshmërisë së tij si dhe rritjen e





bashkëpunimit ndërinstitucional. Gjatë periudhës raportuese është përmirësuar bashkëpunimi ndërsektorial mes strukturave që koordinojnë realizimin e masave në zbatim të planit të veprimit. QKEDH koordinoi dhe zhvilloi disa takime dhe tryeza pune për të diskutuar mbi çështjet e ngritjes së “Mekanizmit Kombëtar të Referimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” i cili është një iniciativë e implementuar nga LKGV në bashkëpunim të ngushtë me QKEDH me mbështetjen e GCERF. të ndërtohet Në qendër të tij do të jenë QKEDH - MSHMS - Pushtetit Lokal<sup>2</sup> si institucione koordinuese dhe monitoruese funksionimit të pushtetit qendror dhe lokal që do të krijohet.

#### 4. ZBATIMI I PLANIT TË RIINTEGRIMIT

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku” për 37 (tridhjetë e shtatë) shtetas të riatdhesuar, QKEDH në bashkërendim me institucionet përkatëse ka vijuar me koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të cilat zhvillohen në kuadër të zbatimit të procesit të ri-integrimit të tyre pas vendosjes në komunitet.

QKEDH ka vijuar aktivitetin e grumbullimit të informacioneve, raporteve dhe koordinimin mbi zbatimin e procesit të ri-integrimit të 13 (trembëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan me datë **27 Maj 2022**, 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datën **1 Gusht 2021**, si dhe të 5 (pesë) shtetasve të riatdhesuar në **27 Tetor 2020** nga vendet e konfliktit (Siri dhe Irak).

Gjatë periudhës raportuese QKEDH ka vijuar me realizimin e veprimtarisë së masave të planifikuara për të përmbushur objektivat e Planit të Veprimit në zbatim të **Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025** të miratuar me VKM Nr.81, date 14.02.2023, me fokus të veçantë në procesin e rehabilitim-riintegrimit dhe risocializimit të 37-shtetasve shqiptar të riatdhesuar nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak.

Lidhur me rastet e identifikuar dhe të raportuara ndaj institucioneve të ngarkuar, QKEDH ka koordinuar, zhvilluar dhe monitoruar takimet e GTN-ve të ngritura për secilin rast ku janë shqyrtuar ecuria e rasteve dhe vlerësuar nevojat e tyre pas vendosjes në komunitet. Në zbatim të planit të riintegrimit, përgjatë 6-mujorit të dytë, QKEDH-ja ka koordinuar dhe zhvilluar **20 (njëzet) takime të Grupeve Teknike Ndër-sektoriale (GTN) të ngritura për të 12 (dymbëdhjetë) familjet e rikthyera nga zonat e konfliktit Siri-Irak** ku është diskutuar mbi monitorimin, përmirësimin dhe problematikat që këto raste kanë reflektuar gjatë kësaj periudhe bazuar në **Planet Individuale të Mbrojtjes (PIM) ngritur për këto familje (veçanërisht fëmijët), si dhe hapat e ndërmarra mbi integrimin e tyre në komunitet.**

---

<sup>2</sup> Mekanizmi Kombëtar i Referimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm është një iniciativë e implementuar nga LKGV në bashkëpunim të ngushtë me QKEDH dhe mbështetjen e GCRERF. Mekanizmi do të ndërtohet bazuar në praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra nga Mekanizmi i Referimit kundër Dhunës në Familje. Projekti pilot do të zbatohet në 20 bashki të konsideruara si zona *hotspot*, ku bën pjesë edhe bashkia Tiranë. Mekanizmi i Referimit për KEDH do të ndërtohet në nivel vendor dhe në qendër të tij do të jenë QKEDH dhe MSHMS si institucione koordinuese dhe monitoruese. Në secilën bashki të targetuar do të caktohet një koordinator vendor, i cili do të trajnohet dhe mbështetet në vazhdimësi nga LKGV për të shërbyer si një urë lidhëse mes institucioneve vendore, pjesë të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike, QKEDH, MShMS dhe ofruesve të shërbimeve dhe OJF.



Theksojmë se edhe gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2023, aktiviteti i QKEDH-së është fokusuar në koordinimin me PMF-të përkatëse për identifikimin e nevojave të shtetasve të rikthyer dhe adresimin e problematikave të organizatat mbështetëse<sup>3</sup>. Këto organizata mbështetëse të gjitha familjet me plotësimin e nevojave të paraqitura për veshmbathje, mjete didaktike, medikamente paketa humanitare dhe shërbime ekstra në raste nevojash imediate.

Në kuadër të procesit të ri-integrimit që po zhvillohet për fëmijët e rikthyer nga zonat e konfliktit Siri-Irak me koordinim të QKEDH-së, të 24(njëzet e katër) fëmijët e rikthyer që janë në moshë shkollore kanë ndjekur procesin mësimor në shkolla me Plane Individuale të hartuara nga MAS si dhe ato të mësuesve mbështetës të kontraktuar nga bashkëpunëtorët e QKEDH-së për të koordinuar këtë proces<sup>4</sup>, lehtësuar procesin mësimor dhe krijuar e kushtet e përshtatshme për riintegrimin mësimor të tyre; nga këta 5(pesë) fëmijë ndjekin arsimin e mesëm profesional në shkolla profesionale publike, një fëmijë vijon mësimin në shkollën e mesme jopublike “Tirana Jone”<sup>5</sup> dhe një po ndjek Liceun Artistik Jordan Misja. Fëmijët më të vegjël kanë frekuentuar normalisht kopshtin dhe çerdhen. Gjithashtu, 6(gjashtë) prej fëmijëve ndoqën kurset e gjuhëve të huaja në nivelet përkatëse. Me qëllim risocializim e tyre, 6-fëmijë po vazhdojnë të ndjekin kurse rekreative, 5 prej të cilëve ndjekin kurse futbollit dhe njëri prej tyre aktivizohet me kurs picture. Këto aktivitete mbështeten nga organizata partnere TdH dhe LKGV me mbështetjen e GCERF.

Duke vlerësuar se përfshirja në proceset arsimore është një rrugë efektive në drejtim të rehabilitimit dhe ri-integrimit të fëmijëve të kthyer nga Siria e Iraku, gjatë muajve korrik-dhjetor 2023, aktiviteti i QKEDH në këtë aspekt vijoi si më poshtë:

- ✓ Fillimi i këtij 6-mujori e përqendroi vëmendjen e QKEDH-së në koordinimin me ZVA-Tiranë për sigurimin e dëftesave të arsimit të detyrueshëm bazë për 4(katër) prej fëmijëve të cilët mbaruan këtë cikël arsimor, pas identifikimit të problematikave nga PMF-të përkatëse lidhur me mosgjenerimin e tyre në portalin e-albania<sup>6</sup>, proces të cilin e monitoroi QKEDH deri në finalizim të tij.
- ✓ Gjatë pjesës së parë të këtij 6-mujori, QKEDH zhvilloi takime me përfaqësues të AKPA për të diskutuar mbi mundësinë e regjistrimit në arsimin e mesëm të fëmijëve të rikthyer nga zonat e konfliktit të cilët kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar, në një nga shkollat profesionale publike të cilat janë në varësi të AKPA. Njëpërmjet bashkërendimit të QKEDH-së me AKPA u bë i mundur regjistrimin e 3(tre) fëmijëve<sup>7</sup> në shkolla të mesme profesionale të përzgjedhura prej tyre, njëpërmjet një procedure lehtësuese, pasi këta fëmijë nuk mund të regjistroheshin me procedurën e përcaktuar nga MAS për shkak të pamundësisë së gjenerimit të dëftesave nga sistemi SIMPS<sup>8</sup>. QKEDH në koordinim me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës dhe drejtoritë e shkollave të mesme

<sup>3</sup> Terres de Hommes (TdH) dhe Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV)

<sup>4</sup> Konkretisht Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV), International Organisation for Migration (IOM), Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

<sup>5</sup> Me dakortësimin e marrë nga Drejtoria e Antiterrorit

<sup>6</sup> Për shkak të problematikës që mbartin këta fëmijë, disa prej tyre nuk kanë prinder ose për shkak të qëndrimit në vendet e konfliktit për një kohë të gjatë, ata kanë probleme me dokumentacionin.

<sup>7</sup> Konkretisht fëmijët AK, AM dhe OG të cilët mbaruan ciklin e detyrueshëm të arsimit bazë.

<sup>8</sup> Sistemi i menaxhimit të informacionit parauniversitar



ku janë regjistruar fëmijë të rikthyer, bënë të mundur që nisja e vitit të ri akademik të zhvillohej normalisht për këta fëmijë.

✓ QKEDH koordinoi dhe zhvilloi një takim me aktorët e përfshirë në proces për ndjekjen dhe lehtësimin procedurave për pjesëmarrjen e një prej të miturve në konkursin për vazhdimin e Liceut Artistik Jordan Misja (dega pikturë). Me bashkërendim të QKEDH, ZVA Tiranë dhe PMF NjA.12, u bë e mundur që i gjithë procesi të zhvillohej në mënyrë sa më të përshtatshme me këtë rast.

✓ Në lidhje me 4(katër) fëmijët të cilët filluan klasën e parë në arsimin e detyrueshëm bazë, QKEDH vijoi mbështetjen e PMF-ve në kryerjen e procedurave për regjistrimin e tyre në shkollat përkatëse sipas Njësive Administrative ku janë vendosur. Gjithashtu, QKEDH bashkërendoi me Zyrën Vendore Arsimore Tiranë për zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë regjistrimit të tyre në shkolla.

✓ Në nisje të vitit shkollor, QKEDH koordinoi me organizatat partnere për sigurimin e mësuesve mbështetës për të gjithë fëmijët të cilët ndjekin procesin mësimor në vitin e akademik 2023-2024.; gjithashtu, edhe për pajisjen e tyre me mjeteve logjistike dhe didaktike.

✓ Në lidhje me problematikën e hasur me fëmijët të cilët filluan klasën e parë në vitin shkollor 2023-2024 përsa i përket regjistrimit zyrtar në SMIP për shkak të mungesës së dokumenteve të identifikimit, QKEDH po koordinon me PMF-të dhe organizatën TLAS për regjistrimin e tyre në regjistrat e posaçëm në mënyrë që të pajisen me numër personal identifikimi për të kryer sa shpejt zyrtarisht regjistrimin e tyre në këtë sistem.

✓ QKEDH koordinoi me me PMF-të e rasteve, MAS dhe AKSHI për regjistrim e tyre manual në këtë system, deri më tani nuk kemi mundur të ndërhyjmë në sistem por jemi në pritje të një përgjigje nga institucionet.

✓ Përsa i përket 5(pesë) fëmijëve të cilët janë duke ndjekur arsimin e mesëm në shkolla profesionale, QKEDH parashtroi kërkesën zyrtare pranë AKPA për kryerjen dhe marrjen e vlerësimeve mujore të ecurisë së tyre në procesin mësimor.

✓ Përgjatë kësaj jave, në kuadër të procesit të riintegrit të fëmijëve, QKEDH zhvilloi takim me drejtuesit e shkollës ku po ndjek arsimin e mesëm një prej fëmijëve (ED). Në këtë takim u diskutua mbi disa problematikat ta shfaqura nga rasti lidhur me përshtatjen në këtë shkollë dhe cikël arsimor, si dhe mbi zgjidhjet për kapërcimin e tyre.

✓ QKEDH bashkërendoi me AKPA për kryerjen dhe marrjen e vlerësimeve mujore të ecurisë mujore të fëmijëve që ndjekin shkollat e mesme profesionale, duke i përcjellë edhe formatin specifik për këtë vlerësim.

Në vijim të procesit të riintegrit të fëmijëve të rikthyer nga zonat e konfliktit Siri-Irak me qëllim riintegrimin dhe risocializimin e tyre në komunitet me koordinim të QKEDH-së, **u bë e mundur pjesëmarrja në kampet verore për 7(shtatë) prej fëmijëve të rikthyer<sup>9</sup>.**

---

<sup>9</sup> QKEDH koordinoi me PMF që menaxhojnë fëmijët e rikthyer nga zonat e konfliktit Siri-Irak dhe organizatës Observatori për të Drejtat e Fëmijëve për pjesëmarrjen e tyre në kampet verore që do të organizohen nga Qendra komunitare “Të qëndrojmë së bashku” të cilat u zhvilluan gjatë muajit korrik.



Lidhur me procesin e riintegrit të njërit prej të miturve të kthyer i cili ka përfunduar ciklin e detyrueshëm bazë, por nuk ka pranuar të vijoj procesin e arsimit të mesëm, QKEDH i ka kushtuar vëmendje të veçante punësimit të tij të ligjshëm me kohë të pjesshme<sup>10</sup>, duke u koordinuar dhe me Specialistët e DA; gjithashtu, po vijon koordinimin me organizatat mbështetëse për fillim e punës pranë një biznesi.

**Nën orientimin e QKEDH, vëmendja ka shkuar në adresim të mbështetjes së grave dhe fëmijëve,** duke orientuar, drejtuar, lehtësuar punën e institucioneve përkatëse. Kjo mbështetje konsiston në identifikimin dhe mbështetjen për ambientet e marra me qira<sup>11</sup> ose për përfitimin e bonusit të qirasë dhëne nga Bashkia Tiranë, ofrimin e mbështetjes për medikamente apo procedura mjekësore të nevojshme<sup>12</sup>, suportimin e procesit të aplikimit për dokument identifikimi të vlefshëm<sup>13</sup>, vijimin e procedurave administrativo-gjyqësore për regjistrimin e të miturve pa shtetësi<sup>14</sup>, procesin e regjistrimit dhe vendosjes e të miturve në shkollë, çerdhe/kopsht dhe mbulimin e kostove për shpenzimet mujore nëpërmjet pajisjes me karta me vlerë monetare për të mbuluar nevojat e tyre<sup>15</sup>, sigurimin dhe mundësimin e krijimit të kushteve me staf mbështetës rehabilitues për të miturit, si në qasjen psiko-sociale por dhe atë edukative dhe argëtuese<sup>16</sup>.

Në lidhje me sigurimin e një nevoje bazike për familjen e cila jeton në zonën e NJ. A 3, QKEDH në bashkëpunim me PMF- në që mbështet rastin, koordinoi një takim në terren me DPN1<sup>17</sup>, mbi nevojën për vlerësimin e ambjentenve të shtëpisë së rastit për të bërë të mundur shtesën e një ambinti tualet të brendshëm për fëmijët, e cila derimë-tani nuk ka pasur zhvillim por jemi në pritje të një përgjigje zyrtare nga institucioni i BT.

Në kuadër të zbatimit Planit të Veprimit 2023-2025, veçanërisht në lidhje me programet e rehabilitimit dhe riintegrit, fokusi kryesor i QKEDH është fuqizimi ekonomik i grave.

Fuqizimi i grave në Shqipëri mbetet një sfidë e madhe për vendin. QKEDH ka bërë përpjekje të rëndësishme për t'i trajtuar këto sfida përmes angazhimeve lokale për barazinë gjinore. Kur gratë janë të fuqizuara nga ana sociale dhe ekonomike, ato shndërrohen në një forcë të madhe për ndryshim në komunitetin e tyre. Pabarazitë që ekzistojnë midis burrave dhe grave e bëjnë të vështirë që gratë të përdorin potencialin e tyre. Fuqizimi ekonomik i grave është një mjet i rëndësishëm për t'i mbështetur ato në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, abuzimit dhe diskriminimit brenda familjeve dhe

---

<sup>10</sup> Pasi djali ishte punësuar pranë një pricerie pa informuar institucionet përgjegjëse që janë të përfshira në procesin e ri-integrimit të kësaj familje

<sup>11</sup> Nën koordinim e QKEDH, organizatat partnere me mbështetjen e partnerit strategjik GCERF suportojnë/ kompensojnë pagesat e qirave të banesave.

<sup>12</sup> Përmes koordinimit të QKEDH-së dhe MSHMS.

<sup>13</sup> Përmes koordinimit dhe lehtësimit të QKEDH dhe MB/ Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në MB si dhe DPPSH.

<sup>14</sup> Ky proces po kryhet përmes koordinimit dhe lehtësimit të QKEDH me organizatat e shoqërisë civile, i specializuar në fushën e regjistrimit të personave pa shtetësi, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS). Ky partner lokal ka realizuar hapat ligjorë të parashikuar në legjislacion

<sup>15</sup> Siguruar nga organizatat TdH dhe LKGV, sipas mbështetjes së ofruar për familje

<sup>16</sup> Këto shërbime shtesë janë jashtë skemës së ofrimit të shërbimeve nga ana e institucioneve shtetërore, si në nivel qendror dhe nga ai vendor. Ato janë ofruar nga palët e treta përmes zbatimeve të projekteve konkrete me fokus specifik në P/KEDH, të cilat vijnë si rezultat i punës koordinuese, advokuese, nxitëse të Qendrës QKEDH me donatorë kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë.

<sup>17</sup> Drejtoria e Përgjithshme Nr .1 e Punëtorëve të Qytetit.



komuniteteve ku ato jetojnë. Fuqizimi rrit pavarësinë ekonomike të grave, fuqinë vendimmarrëse dhe liritë sociale duke sjellë një efekt pozitiv në marrëdhëniet gjinore në nivel familjar dhe komuniteti.

Në kuadër të këtij fokusi, QKEDH në bashkëpunim me aktorë të rëndësishëm në këtë fushë ka bërë të mundur që një prej grave të riadhesuara këtë gjashtëmuajor të përfundoj kursin profesional (për rrobaqepësi). Në vazhdim, ky rast shfaqti dëshirën për të ndjekur arsimin e mesëm me qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e mundësive për punësim në të ardhmen, për të cilën QKEDH bashkërendoi me ZVA Tiranë për fillimin e procedurave të regjistrimit, të cilat u ndërpre në pasiguri pasi rasti u tërhoq për shkak të ngarkesës që mbart menaxhimi i fëmijëve; vijojnë përpjekjet e QKEDH-së në bashkëpunim me organizatat partnere dhe PMF-në që mbështet rastin për mundësinë e punësimit të saj.

QKEDH vijon koordinimin me organizatat partnere mbi mundësimin e ofrimit të një kursi profesional për shtetase A.K. QKEDH në bashkëpunim me AKPA dhe PMF e Njësisë 12 bënë të mundur regjistrimin e dhënien e statusit si punëkërkuese e papunë për A.K.

Në kuadër të proceseve të riintegrit të grave të rikthyera nga zonat e konfliktit, ku fokusi i QKEDH është fuqizimi ekonomik i tyre nëpërmjet aftësimin profesional me qëllim punësimin në të ardhmen, u zhvillua takim me përfaqësues të TdH mbi mundësinë e ndjekjes së fazës së dytë të kurseve profesionale për dy prej tyre të cilat kanë përfunduar fazën e parë të këtyre kurseve<sup>18</sup>. Gjithashtu, u diskutua mbi mundësinë që djali AR të futet në procesin e intership-it të paguar për të dhënë mundësi që të aftësohet sa më shumë pranë një auto-oficine.

Në kuadër të riintegrit të personave të rikthyer nga zonat e konfliktit, lidhur me rasti BK e cila është atashuar pranë një biznesi si ndihmës ekonomiste, (ku ka mbaruar trajnimin për këtë fushë për 3 muaj) dhe aktualisht është në periudhë prove në një subjekt, QKEDH nëpërmjet organizatës TdH ka mundësuar që rasti të futet në procesin e intership-it të paguar për 4(katër) muaj për të dhënë mundësi që të aftësohet sa më shumë pranë subjektit aktual ku po punon rasti.

Gjithashtu, në vijim të angazhimit profesional të grave të rikthyera, për rastin EV, cila përfundoi kursin për rrobaqepësi iu parashtrua kërkesa kësaj organizate edhe për mbështetjen e këtij rastit për tu punësuar si rrobaqepëse pranë ndonjë kompanie (me kohë të pjesshme për shkak të impenjimit me 4 fëmijët e saj).

QKEDH vazhdon rolin e saj koordinues në nivel kombëtar, në kuadër të realizimit dhe ndjekjes e proceseve të rehabilitim-riintegrit dhe risocializimit të të rikthyereve nga zonat e konfliktit Siri-Irak. Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti i QKEDH u përqendruar në vazhdimin e marrëdhënieve me organizatat mbështetëse të proceseve RRR:

---

<sup>18</sup> Dy prej të rikthyerave ndoqën kurse profesionale (për rrobaqepësi dhe kuzhinë) pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë, me mbështetjen e IDM.



- ✓ QKEDH ka zhvilluar takim me përfaqësues të Terres de Homme (TdH) mbi vazhdimin e mbështetjes së familjeve të rikthyera në kuadër të projektit të ri të GCERF që po zbatohet nga kjo organizatë.
- ✓ QKEDH bashkërendoi dhe zhvilloi takim me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve, përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë, përfaqësues të Terres de Homme (TdH) dhe dy organizatat partnere në konsorcium TLAS dhe IANS mbi menaxhimin dhe mbështetjen e disa prej familjeve të rikthyera<sup>19</sup> në kuadër të projektit të ri të GCERF që po zbatohet nga kjo organizatë
- ✓ Drejtori i QKEDH zhvilloi takim me përfaqësues të TdH dhe LKGV mbi vijimin e mbështetjes në fushën e parandalimit të EDH si dhe menaxhimin dhe mbështetjen e familjeve të rikthyera nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak, në kuadër të projektit të ri të GCERF që do të zbatohet nga këto organizata.
- ✓ Vijon puna koordinuese e QKEDH me organizatat partnere TdH dhe LKGV për sigurimin sa më shpejt të mësuesve mbështetës për të gjithë fëmijët të cilët ndjekin procesin mësimor.
- ✓ QKEDH ka zhvilluar takime me organizatën Linja e Këshillimit Gra dhe Vajza për prezantimin e një partneriteti të ri, me organizatën (GADC)<sup>20</sup>, një partneritet që vjen në kuadër të vazhdimësisë së projektit me GCERF. Në takim ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Komitetit të Helsinkit dhe organizatës SHIIS, ku u diskutua mbi aktivitetet e ardhshme në kuadër të punës për parandalimin e EDH si dhe fuqizimin e të rikthyerve nga zonat e konfliktit dhe familjarëve të tyre.
- ✓ QKEDH ka koordinuar dhe marrë pjesë në takimin e zhvilluar me përfaqësues të Bashkisë së Tiranës, organizatës TdH dhe IANS me qëllim vazhdimin e mbështetjes psikologjike për të rikthyerit nga zonat e konfliktit Siri/Irak e cila do të vijoj të ofrohet nga IANS (më parë janë mbështetur nga IOM). Gjithashtu, gjatë takimit u vlerësua e nevojshme dhënia e mbështetjes psikologjike për katër fëmijë të rikthyer me psikologë të përshtatshëm për moshën dhe specifikat e tyre<sup>21</sup>.
- ✓ QKEDH, ka përcjellë pranë organizatës TdH kërkesën për mbështetjen e ndjekjes së kurseve të gjuhëve të huaja për fëmijët.

Përgjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2023, ka vijuar mbështetje psikologjike për përfituesit duke përfshirë kryerjen e sesioneve individuale me fokus në këshillimin psikologjik, aktivitete psikosociale, psikoedukim dhe aplikim të testeve të nevojshme të vlerësimit; zbatimin e teknikave të artit dhe lojës gjatë seancave me fëmijë që ndjekin moshën, vështirësitë dhe zhvillimin përkatës të fëmijës; zbatimin e testeve projektive për të kuptuar problemet rrënjësore dhe për të parë dinamikën e familjes, çështjet e komunikimit dhe ndërveprimin; aplikimi i teknikave me qasje psikoanalitike gjatë seancave individuale me prindërit; si dhe aplikimi i teknikave të terapisë në grup me kombinimin e një qasjeje të orientuar drejt familjes. Seancat psikologjike merren 1 deri në 2 herë në javë, në varësi të nevojës së rastit. QKEDH ka grumbulluar raportimet periodike të psikologëve mbështetës dhe bashkërenduar punën me PMF-të, që janë menaxherë të rasteve dhe vazhdojnë të monitorojnë proceset e zhvilluara

---

<sup>19</sup> Konkretisht për famijlet AK, OG, RB, LK, KZ të cilat deri tani mbështeteshin nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza(LKGV).

<sup>20</sup> Gender Alliance for Development Centre (GADC) e cila është pjesë e konsorciumit me GCERF për zbatimin e projektit “Forcimi i qëndrueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm përmes mbështetjes dhe edukimit

<sup>21</sup> Deri me tani, këta fëmijë merrnin mbështetje psikologjike nga psikologët që ofronin ndihme psikologjike për nënat.





për njësitë familjare të këtyre shtetaseve. Gjithashtu, bashkërendon punën me psikologët që vazhdojnë me seancat këshilluese në kuadër të terapisë që zbatohet si për nënat dhe të miturit.

Në kuadër të proceseve të ri-integrimit dhe risocializimit të të rikthyerëve nga zonat e konfliktit, QKEDH në bashkëpunim me Urdhrin e Psikologut identifikuan 2(dy)psikologë të cilët po angazhohen në mbështetjen psikologjike të fëmijëve dhe grave në Njësitë Administrative përkatëse ku janë ri-integruar. Gjithashtu, nën koordinimin e QKEDH dhe PMF e NjA14 u bë prezantimi i fëmijës HS me psikologun që do të angazhohet në dhënien e mbështetjes psikologjike të saj<sup>22</sup>.

Në vijim të mbështetjes psikologjike ofruar për fëmijët, nën bashkërednimin e QKEDH me PMF-të u krye vlerësimi psikologjik i katër fëmijëve të mitur të dy prej familjeve të riatdhesuara në Maj 2022, nga partneri mbështetës TdH, me qëllim dhënien e mbështetjes psikologjike me psikologë të përshtatshëm për moshën dhe specifikat e tyre<sup>23</sup>. Kjo nevojë u parashtrua gjatë GTN-ve të zhvilluara mbi ecurinë e këtyre familjeve në procesin e riintegritimit, nga aktorë e përfshirë në këtë proces.

Një rendësi të vecantë lidhur me proceset R&R&R përbën ofrimi i mbështetjes teologjike i cili vazhdon të merret nga dy gra dhe një fëmijë, nevojë e lindur për shkak të disinformimit që kanë në lidhje me ritet fetare dhe përshtatjen e tyre sa më lehtë me komunitetin.

Në vijim të situatës së krijuar në muajin shtator mbi ecurinë e proceseve të ri integritimit, ku nënat e rikthyerat janë paraqitur pranë SPAK, mbi mbylljen e hetimeve dhe hapjen e proceseve gjyqësore me akt akuzën “pjesëmarrës në organizatë terroriste” dhe të gjithë destabilitetin që kanë shfaqur familjet, në mënyrë që mos të krijohet regres në proceset e ri integritimit për fëmijët e rikthyer, QKEDH koordinoi dhe zhvilloi një takim Ad-Hoc me të gjithë PMF-të që janë të përfshira drejtpërdrejtë në këto procese<sup>24</sup>, për ti dhënë kohë familjeve për të mos krijuar panik të panevojshëm dhe për të mos dëmtuar ecurinë e proceseve derimëtani.

QKEDH ka zhvilluar takime me drejtorinë e Shërbimit Social në Bashkinë Tiranë për ngritjen e kapaciteteve të strukturave përkatës për proceset e riintegritimit dhe risocializimit. Gjatë takimeve u diskutua mbi shtimin e një Aneksi në planin Social të Bashkisë Tiranë dhe për ngritjen e VKB(Vendimi të Këshillit Bashkiak) për rastet përjashtimore që kemi në çerdhe dhe kopshte, si dhe kemi punuar për disa ndryshime të përshkrimeve të punës së Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës, të cilat do të kalojnë me anë të burime njerëzore për zbatimin e tyre.

Në vijim përse i përket fëmijëve të cilët mbushin moshën 18 vjeç, QKEDH zhvilloi takim dhe përcolli kërkesën pranë Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Tiranë për bashkëpunimin e mëtejshme për vijueshmërinë e procesit të riintegritimit të tyre dhe kalimit të administrimit të Planeve individuale të Punonjësi Social i Bashkisë.

Në lidhje me problematikën e fëmijëve të cilët kanë lindur në zonat e konflikti dhe janë të peregjistruar në regjistrin e përkohshëm të Gjendjes Civile, konkretisht 4 (katër) fëmijë (QKEDH po koordinon me

<sup>22</sup> Rasti HS pas refuzimit të mbështetjes psikologjike nga psikologjia e mëpashme nuk pranonte të merrte këto mbështetje.

<sup>23</sup> Deri më tani, këta fëmijë merrnin mbështetje psikologjike nga psikologët që ofronin ndihmë psikologjike në kuadër të terapisë familjare(nena-fëmijë)

<sup>24</sup> Në takim morën pjesë: PMF NjA9, NjA 3, NjA6, NjA12,NjA Kashar, NjA11, NjA 14, NjA Vaqarr



Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për zgjidhjen e problemit, pasi Gjendja Civile Kashar dhe NJA14 vazhdojnë të mos kenë akses në regjistrin e përkohshëm për të kryer këtë proces pasi në listën e shteteve të listuara mungon shteti Siri që fëmijët kanë lindur.

Në lidhje me mbështetjen shëndetësore, QKEDH vijon koordinimin me institucionet për plotësimin e nevojave për të 37-të rasteve të kthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak. Konkretisht në lidhje me nevojat e shfaqura nga një rast specifik për shkak të problemeve shëndetësore, u koordinua me përfaqësuesit e MSHMS<sup>25</sup> dhe PMF Kashar, për kryerjen e kontrolleve të detajuara shëndetësore të rastit, ndërhyrë specifikisht nga Drejtoria Operacionale e QSUT.

Vemendje të shtuar QKEDH i kushton përpjekjes për përfshirjen e të riatdhesuarerev në aktivitete sociale si pjesë e procesit të risocializimit të tyre; nëpërmjet LKGV u organizua workshop-i “Zhvillimi i Fëmijës” me pjesëmarrjen e grave të komunitetit të NJA 3 dhe të një prej të riatdhesuarave të vendosura në këtë njësi administrative, me qëllim integrimin e saj në komunitet.

Në funksion të të gjithë proceseve RRR, vazhdon puna njëkohësisht edhe me shërbimin ligjor i cili është mundësuar dhe vazhdon mbështetjen nga TLAS)mbështetur financiarisht nga GCERF. Ky proces është kompleks dhe dinamik për nga natyra sensitive dhe statusi që përfituesit mbartin që prej largimit të tyre. Në vijim, përgjatë periudhës raportuese, situata për të gjithë të kthyerit nëpërmjet tre misioneve të riatdhesimeve paraqitet: **Në total janë hapur 37 (tridhjetë e shtatë)** çështje ligjore për të cilat TLAS-si ka ofruar shërbim ligjor për personat e kthyer. Duke qenë se procesi i regjistrimit të fëmijëve zgjat në kohë sepse nevojitet të vërtetohet amësia nga rezultati i analizës së ADN-së, 28 (njëzet e tetë) prej çështjeve vazhdojnë të jenë në proces ndërsa 9 (nëntë) të tjera janë të përfunduara me sukses. Përfituesit gjatë proceseve gjyqësore kanë si përfaqësues të tyre avokatët mbështetës të TLAS si dhe marrin asistencë ligjore familjare të vazhdueshme.

Gjatë periudhës raportuese, u zhvillua seanca gjyqësore e radhës të të miturit A.K për vlerësimin e masës së mbrojtës të marrë me vendim nr.24788/1 nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Bashkia Tiranë dhe vendosjen në kujdestari alternative të gjyshes E.S. Gjykata e Rrethit Qyqësor Tiranë, bazuar në provat dhe faktet që disponon, vendosi shtyrjen e seancën së radhës në muajin shkurt pasi gjyqtari kërkon prova fakte për ta vërtetuar këtë rast, një vështirësi e hasur në çdo proces pasi të rikthyerit nuk disponojnë dokumenta mbi zhdukjen apo vdekjen e personave në Siri.

Në kuadër të realizimit të masave parashikuar në planin e veprimt, QKEDH ka inicuar kryerjen e një vlerësimi mbi proceset e riintegimit të tyre me të gjitha shërbimet dhe mbështetjen ofruar për mbarëvajtjen e këtyre proceseve. Ky vlerësim, po kryhet nëpërmjet hartimit të një pyetësor, të konsultuar edhe me profesionistë të vijës së parë (psikologë) dhe ka finalizuar dokumentin me titull “*Vlerësimi i rezultateve të përqëndruara te personat e rikthyer nga zonat e konfliktit*”. Rezultatet që do të arrihen, janë ato që çdo program synon të arrijë dhe përfshijnë rezultatet afatshkurtra, afatmesme dhe ato afatgjata.

---

<sup>25</sup> Nëpërmjet OSHKSH (Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor) u planifikua zhvillimi i vizitave të nevojshme mjekësore






## 5. AKTIVITETE INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE RITJA E KAPACITETEVE

Përgjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2023, QKEDH, në zbatim të dhe Vendimit Nr.81 datë 14.02.2023 mbi “Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025”, i ka kushtuar rendësi të veçante aktiviteteve me qëllim ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe aktorëve të vijës së parë të sektorëve të ndryshëm shtetërorë të institucioneve civile dhe atyre të sigurisë, të të rinjve, grave, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë relevantë të shoqërisë të përfshirë në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Përgjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023, QKEDH ka vijuar me zhvillimin e aktiviteteve në fushën e edukimit dhe në përmbushje të këtij objekti, duke u koordinuar edhe me institucione të përfshira në çështjet e P/KEDH dhe OSHC.

QKEDH ka realizuar **52(pesëdhjetë e dy) trajnime/workshop-e** në kuadër të rritjes së kapaciteteve të aktorëve të vijës së parë ku morën pjesë **1280 (njëmijë e dyqind e tetëdhjetë )** pjesëmarrës.



Në funksion të zhvillimit të këtij objekti, QKEDH në vijim të rolit të saj koordinues për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të vijës së parë, konkretisht psikologëve dhe punonjësve social gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2023 ka kryer këto 11(njëmbledhjetë) aktivitete:



- Në bashkëpunim me IDM dhe Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë u zhvillua trajnimi i akredituar nga ky institucion<sup>26</sup> i ndarë në 4(katër) data të ndryshme për psikologët mbi temën “Identifikimi, trajtimi dhe parandalimi i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar”<sup>27</sup>. Trajnimi kishte qëllim ngritjen e kapaciteteve të psikologëve në procesin e identifikimit, trajtimit dhe parandalimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Gjithashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, dhe në vijim të trajnimeve të zhvilluara me psikologët, QKEDH koordinoi me organizatën Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori)<sup>28</sup> për zhvillimin e 2(dy) trajnimeve online me temë: “Identifikimi, trajtimi dhe parandalimi i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar”. Këto trajnime kishim qëllim ngritjen e kapaciteteve të psikologëve në procesin e identifikimit, trajtimit dhe parandalimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Në kuadër ndërgjegjësimit dhe ngritjes së kapaciteteve, QKEDH koordinoi me organizatën Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve për zhvillimin e 2(dy) trajnimeve me temë “Identifikimi, trajtimi dhe parandalimi i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar” me studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale. Trajnimi kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve të studentëve të punës sociale, si punonjës social të ardhshëm, në procesin e identifikimit, trajtimit dhe parandalimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Në kuadër ndërgjegjësimit dhe ngritjes së kapaciteteve, QKEDH koordinoi me organizatën Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve<sup>29</sup> për zhvillimin e 3(tre) sesioneve të trajnimit “Identifikimi, trajtimi dhe parandalimi i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar” i zhvilluar me studentët e Fakultetit të Psikologjisë. Trajnimi kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve të studentëve të psikologjisë, si psikologë të ardhshëm, në procesin e identifikimit, trajtimit dhe parandalimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Në zbatim të planit të veprimit të miratuar, si dhe në kuadër të proceseve të riintegrit të fëmijëve të rikthyer në komunitet dhe në shkollat ku janë vendosur, QKEDH në bashkërendim me AKPA dhe drejtoritë e shkollave profesionale zhvilluan 2(dy) trajnime informuese/ ndërgjegjësuëse me mësuesit e shkollave të mesme janë vendosur fëmijë të integruar<sup>30</sup>. Këto trajnime u zhvilluan me mbështetjen e LKGV, në kuadër të programit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, me mbështetjen e GCERF. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte paraqitja

<sup>26</sup> Ky cikël trajnimesh nisi në muajin qershor, kur u zhvillua i pari.

<sup>27</sup> Ky trajnim u zhvillua në 5 data, me qëllim përfshirjen sa më të gjerë të specialistëve të kësaj fushe.

<sup>28</sup> Ky trajnim organizohet në kuadër të programit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, i cili po zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe Qendrën e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, nën koordinimin kombëtar të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me mbështetjen e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF).

<sup>29</sup> Ky trajnim organizohet në kuadër të programit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, i cili po zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe Qendrën e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, nën koordinimin kombëtar të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me mbështetjen e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF).

<sup>30</sup> Këto trajnime u zhvilluan me mësuesit e shkollave të mesme: Shkollës Teknike-Elektrike “Gjergj Canco” dhe Shkollës së Mesme të Ndërtimit “Karl Gega” ku janë vendosur fëmijë të integruar.



e informacionit të nevojshëm në lidhje me qasjen që duhet përdorur me këtë kategori fëmijësh, duke theksuar bazën ligjore, punën individuale, qasjen psikologjike, si dhe mënyrat e bashkëpunimit me struktura të pushtetit vendor të angazhuara në procesin e ri-integrimit. Gjithashtu, u zhvilluan takime me Drejtorët e Shkollës Teknike-Elektrike "Gjergj Canco" dhe Shkollës së Mesme të Ndërtimit "Karl Gega", ku u diskutua mbi nevojat specifike që mund të kenë fëmijët e rikthyer të cilët do të ndjekin planin mësimor në këto shkolla.

Në kuadër të bashkëpunimit me Rektoratet e Universiteteve në vend u nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në shtator 2023, e cila synon parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Në vijim të kësaj marrëveshje, Drejtori i QKEDH, z. Meidani zhvilloi një takim me dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, Prof. Ass. Dorina Hoxha ku u dakordësua ftesa e QKEDH-së për të kthyer fakultetin në një burim të rëndësishëm të ekspertizës juridike për formulimin e legjislacionit dhe akteve normative për të luftuar radikalizmin dhe ekstremizmin të dhunshëm në vend duke mbështetur kështu jo vetëm qendrën por të gjithë institucionet e përfshira në këtë front. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjes të nënshkruar, të dy institucionet dakordësuan për të bashkëpunuar në ofrimin e mundësive për studentët e Fakultetit të Drejtësisë për të zhvilluar praktikat/stazhet mësimore pranë QKEDH-së, si dhe bashkëpunimin nëpërmjet Qendrës së Kriminalistikës të këtij fakulteti për realizimin e kërkimeve shkencore në fushën e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në vendin tonë.

Në kuadër të bashkëpunimit me palët e treta, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit me organizatën IANS. Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të sigurojë një kornizë bashkëveprimi dhe të rregullojë dhe forcojë bashkëpunimin institucional midis QKEDH dhe IANS në kuadër të zbatimit të programeve P/KEDH në Republikën e Shqipërisë si dhe konsolidimit të qasjeve të integruara për të kthyerit nga ish zonat e konfliktit.

Me qëllim ndërgjegjësimit të komuniteteve, me koordinim të QKEDH, organizata LKGV zhvilloi workshop-in me temë “ Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe integrimi i të rikthyerve në komunitet”, i cili u zhvillua me gratë në Bulqizë, qëllimi i workshop-it ishte ndërgjegjësimi për fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe pranimi i individëve të kthyer në komunitetet ku janë vendosur, sensibilizimi i pjesëtarëve të komunitetit mbi rëndësinë që ka përfshirja e të rikthyerve në komunitet, veçanërisht e fëmijëve, si dhe gjenerimi i alternativave nga komuniteti për lehtësimin e përfshirjes së kësaj kategori shtetasish.

Në vijim të ndërgjegjësimit të komuniteteve, nën koordinimin e QKEDH organizata WCDC organizoi në 4(katër) aktivitete të organizuara nga Nisma e Këshillit të Grave konkretisht te zonave: Mollas, Leshnicë, Kukës dhe MAT, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohjen e faktorëve që mund të çojnë në shfaqjen e ekstremizmit të dhunshëm, dhe parandalimin e tyre. Gjithashtu, me



qëllim forcimin e qëndresës në komunitet, kjo organizatë zhvilloi 4(katër) aktivitete<sup>31</sup> në zonat Postribë, Kukës, Mat.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve si dhe përmbushjes së objektivave të planit të veprimit, QKEDH organizoi në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, Fakultetin e Drejtësisë, IDM, IANS, Qendra e bashkëpunimit Ndërfetar me mbështetjen e OSCE zhvillimin e trajnimit dy ditor të punonjësve të policisë(shefat e rendit) me teme: “Fuqizimi i komuniteteve dhe institucioneve publike për identifikimin dhe raportimin e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit”. Të gjithë pjesëmarrësit u pajisën me certifikatë.

QKEDH në koordinim me partnerin IANS dhe MAS, DPPSH dhe IPO me mbështetjen financiare të Ambasadës Amerikane dhe Prezencës së OSBE u zhvilluan 6(gjashtë) trajnime me pjesëmarrjen e oficerëve të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar me temë “Oficeri i sigurisë në shkollë-Garantues i një mjedisi miqësor dhe të sigurt për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Këto sesione iu dedikuan një procesi gjithëpërfshirës për garantimin e një roli efektiv të oficerit të sigurisë në shkollë, në parandalim, identifikim e hershëm dhe referimin e rastit.

Një vëmendje të shtuar, QKEDH i jep rritjes së kapaciteteve të punonjësve të qendrës, me qëllim përmbushjen e misionit të saj. QKEDH ka bashkëpunuar dhe marrë pjesë, përgjatë këtij viti në 4(katër) trajnime për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të saj, konkretisht:

- Në përmbushje të misionit të qendrës mbi ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteteve në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm, QKEDH ka marrë pjesë në 3(tre) workshop-e rajonale për zhvillimin e kapaciteteve të praktikuesve të vijës së parë me temë: “Ekstremizmin e dhunshëm i krahut të djathtë (EDHKD)”; vizitën studimore: “Gratë dhe fëmijët e rikthyer”, “Rezistenca dhe ri-integrimi: Trajtimi i luftëtarëve të huaj terroristë në Ballkanin Perëndimor i zhvilluar në Prishtinë, me fokus specifik për gratë dhe fëmijët” zhvilluar nga EU RAN për Ballkanin Perëndimor.
- Në vijim të Seminarit R&R të zhvilluar në Prishtinë (muajin shtator) organizuar nga GCERF, QKEDH mori pjesë në takimin e mbajtur online mbi diskutimin e rezultateve dhe gjetjeve, planifikimin e hapave të mëtejshëm dhe finalizimin e dokumenteve të zhvilluar gjatë seminarit.
- QKEDH mori pjesë në seminarin një javor me temë “Programi i Avancuar Veror 2023 për Terrorizëm, Kundër-terrorizmin dhe Sundimin e ligjit” që u zhvillua në Hagë me ftesë të Ministrisë së Jashtme të Hollandës dhe në bashkëpunim me T.M.C Asser Institut dhe Qendrën Ndërkombëtare për Kundër-terrorizmit (ICCT).

Më qëllim ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të vijës së parë, QKEDH në koordinim me partnerin IANS dhe MAS, DPPSH dhe IPO me mbështetjen financiare të Ambasadës Amerikane dhe Prezencës së OSBE, vijuan me zhvillimin e **gjashtë trajnimeve** me pjesëmarrjen e oficerëve të sigurisë në

---

<sup>31</sup> Këto aktivitete po zhvillohen në kuadër të programit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, program që po zbatohet në Shqipëri nga IDM në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe WCDCA nën koordinimin kombëtar të QKEDH, me mbështetjen e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF)



institucionet e arsimit parauniversitar<sup>32</sup> me temë “Oficeri i sigurisë në shkolla- Garantues i një mjedisi miqësor dhe të sigurt për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm<sup>33</sup>. Këto sesione i dedikohen një procesi gjithëpërfshirës për garantimin e një roli efektiv të oficerit të sigurisë në shkollë, në parandalim, identifikim e hershëm dhe referimin e rastit.

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i **Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025**<sup>34</sup>, QKEDH ka vijuar të zbatojë Planin e Veprimit të kësaj Strategjie i cili referon aktivitete që kryhen me ministrinë e linjës në bashkëpunimin me institucionet shtetërore në nivel qendror, vendor dhe me institucione jopublike, në partneritetet e ngritura me organizatat ndërkombëtare për procesin e Rehabilitimit, Ri-integrimit dhe Risocializimit në komunitet, në bashkëpunimin me OSHC-të, me palët e treta, si dhe me rrjetet e ngritura pranë Qendrës.<sup>35</sup>

Me qëllim nxitjen e bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe shkëmbimin e njohurive mbi praktikat R&R midis aktorëve të vijës së parë në nivel vendor, QKEDH koordinoi me organizatën Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve 5(pesë) takime rrjetëzuese me aktorët lokal dhe përfaqësues të vijës së parë<sup>36</sup>, mbi trajtimin e rasteve që lidhen me çështjet e sigurisë në komunitet dhe ofrimin e shërbimeve të ri-integrimit dhe rehabilitimit për personat e kthyer nga Siria.

Në përmbushje të objektivave të planit të veprimit, si dhe **në kuadër të ndërgjegjësimit të të rinjve:**

- **QKEDH koordinoi dhe zhvilloi në bashkëpunim me organizatën LKGV workshop-in me temë “Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm” me të rinjtë e qytetit të Bulqizës, me objektiv** ndarjen e informacionit mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, promovimin e kulturës dhe tolerancës, harmonisë shoqërore dhe fetare si dhe nxitja e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit ndërmjet të rinjve.
- Në zbatim të Planit të Veprimit të Strategjisë së re P/KEDH si dhe vazhdim të nismës “Shkolla si qendër komunitare”, QKEDH në bashkëpunim me organizatë Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve ka zhvilluar 4 (katër) aktivitete me të rinjtë e qytetit të Tiranës për promovimin e kësaj nisme. Gjithashtu kjo organizate zhvilloi një aktivitet mbi **RFTF-të dhe familjet (të synuara nëpërmjet programit) mbi rinteigrimin dhe komunitetet pritëse.**

Me qëllim mbështjten e proceseve të riinteigrimit dhe risocializmin e fëmijëve, në koordinim me ekspertët e organizatës Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve u zhvilluan kampet verore me pjesëmarrjen e 8(tete) fëmijë të kthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak.

---

<sup>32</sup> Oficerët e Sigurisë që morën pjesë në këto trajnime ishin nga qytetet: Lushnje, Fier, Vlorë, Kurbin, Lezhë, Shkodër, Laç, Pogradec, Bilisht.

<sup>33</sup> Në total janë zhvilluar 6 trajnime me temë “Oficeri i sigurisë në shkolla- Garantues i një mjedisi miqësor dhe të sigurt për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshme”.

<sup>35</sup> Pranë QKEDH-së janë ngritur rrjeti i komuniteteve fetare, rrjeti i medias, ndërsa janë në proces krijimi disa rrjeteve të tjerë.

<sup>36</sup> Këto takime u zhvilluan në Mat, Mollas, Kukës, Postrinë, Pogradec në kuadër të programit “Ri-integrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve të kthyer nga Siria” i cili po zbatohet ne



## 6. KOMUNIKIMI STRATEGJIK

Në përmbushje të këtij objekti dhe në funksion të transparencës mbi aktivitetin e QKEDH-së përgjatë kësaj jave është bërë **12(një) publikime në faqen zyrtare të QKEDH<sup>37</sup>, në rrjetet sociale Twitter<sup>38</sup> dhe në LinkedIn.<sup>39</sup>**

Në përmbushje të objektivit të Komunikimit Strategjik si një nga objektivat e Planit të Veprimit 2023-2025, QKEDH përcolli kontributin mbi draftin final mbi “Riintegrimi në shkollë i fëmijëve të riatdhesuar nga Siria” i cili do të publikohet të RTSH si artikull si dhe do të shfaqet në një kronikë të shkurtër në TV.

Gjithashtu, QKEDH përcolli komentet e saj mbi artikullin mediatik “Demaskimi i keqinformimit fetar në Shqipëri”.

Në funksion të transparencës mbi aktivitetin e QKEDH-së përgjatë kësaj periudhe nëpërmjet AKSHI-it, u bë azhurnimi i Programit të Transparencës në faqen zyrtare të saj. QKEDH bëri plotësimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës në faqen zyrtare të qendrës sipas kërkesave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Në shtator të 2023 u publikua në një nga gazetat pretigjoze angleze INDEPENDENT intervista e bërë me stafin e QKRDH mbi zhvillimin e proceseve të riintegrimin për personat e rikthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak.

Drejtori i QKEDH ka bërë një shkrim i cili është botuar në revistën “Justice Trends”.

QKEDH ka arritur të realizoj 4 artikuj mediatik mbi rehabilitimin dhe ri-integrimin e të rikthyerve nga zonat e konfliktit Siri/Irak dhe qasjen P/KEDH në kuadër të programit Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria. Ky program zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe Qendrën e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë në Shqipëri, nën koordinimin kombëtar të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me mbështetjen e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF).

QKEDH ka realizuar 2 Spote ndëgjegjësues , ----- të kryer nga IDM në kuadër të programit "Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria

---

<sup>37</sup> [www.cve.gov.al](http://www.cve.gov.al).

<sup>38</sup> <https://twitter.com/CenterCve>.

<sup>39</sup> <https://www.linkedin.com/company/centercve/>





Vazhdon ofrimi i këshillimit dhe suportit për individët në risk dhe familjarët e tyre që kanë nevojë për mbështetje apo informacion mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin përmes Linjës Telefonike Kombëtare 0800 4545 me mbështetjen e organizatës LKVG.

## **7. BASHKËPUNIME ME PARTNERË NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR**

Në mënyrë paralele me zbatimin e detyrimeve funksionale për P/KEDH dhe Procesin RRR, gjatë periudhës raportuese, QKEDH, ka vijuar punën në kuadër të përmbushjes së objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën ndaj Terrorizmit dhe zbatimin e Planit të Veprimit 2023-2025.

Vëmendje të shtuar QKEDH i kushton edhe bashkëpunimit me partnerët në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe zhvillimit të partneriteteve me aktorët vendas, rajonal e ndërkombëtarë që punojnë në këtë fushë.

Në kontekstin e produkteve të arritura si rezultat i bashkëpunimit me partnerë në të gjitha nivelet e tij është kontribuar/realizuar në produkte në formën e materialeve/studimeve, 85(tetëdhjetë e pesë) takime/ tryeza pune të përbashkëta të zhvilluara onsite apo online një pjesë e tyre, 2(dy) forume si dhe 4(katër) konferenca ndërkombëtare.

Në vijim të bashkëpunimeve me partnerët në nivel kombëtar, QKEDH zhvilloi takim me përfaqësues të IDM dhe 4(katër) gazetarëve të përzgjedhur<sup>40</sup> mbi realizimin e 4(katër) artikujve mediatik nga këta gazetarë mbi rehabilitimin dhe ri-integrimin e të rikthyerve nga zonat e konfliktit Siri/Irak dhe qasjen P/KEDH.

Në vijim të këtij bashkëpunimi, QKEDH zhvilloi një takim reflektues dhe konsultues me organizatën Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, në kuadër të projektit të GCERF<sup>41</sup> në mbështetje të procesit riintegrit të të kthyerëve nga ish zonat e konfliktit, ku u diskutua mbi udhëzuesin "Për punonjësit e vijës së parë që vënë në lëvizje mekanizmat për mbrojtjen, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të rikthyerëve nga Siria, kryesisht gra e fëmijë" përgatitur nga kjo organizatë për profesionistët e vijës parë.

Në përmbushje të misionit të saj koordinues për riintegrimin e shtetasve të kthyer nga Siri dhe Iraku, rëndësi të veçantë merr edhe partneriteti i ngritur me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare; gjatë kësaj periudhe QKEDH koordinoi dhe zhvilloi takim me përfaqësues të organizatës IOM dhe IANS,

---

<sup>40</sup> Këto artikuj do të zhvillohen në kuadër të projektit të GCERF "Riintegrim i qëndrueshëm i të kthyer nga Siria/Irak", në dakortësimin paraprak me QKEDH dhe feedback-un mbi draft artikullin. Të gjithë gazetarët do të nënshkruajnë edhe Deklaratën e Konfidencialiteti.

<sup>41</sup>Organizatën Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve- partner zbatues i programit "Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria" i cili po zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim(IDM) me mbështetjen e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF)



në kuadër të mbështjetjes psikologjike që IOM<sup>42</sup> ka siguruar për të rikthyerit nga ish zonat e konfliktit, pasi kjo mbështetje do të jepet në vazhdim nga IANS.

QKEDH koordinoi me Komitetin Shqiptar të Helsinkit mbi zhvillimin e trajnimeve të stafit të Insitucioneve të Ekzekutimit të Veprave Penale (IEVP) mbi fushën P/KEDH.

Në kuadër të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar, **QKEDH zhvilloi disa takime online me strukturat e EU RAN (Radicalisation Awareness Network)** për Ballkanin Perëndimor mbi organizimin e seminarit dhe vizitës studimore "Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit të multi-agjencive midis praktikuesve të P/CVE" i cili u zhvillua në muajin shtator në Shqipëri, në bashkëpunim me QKEDH dhe me pjesëmarrjen e praktikuesve nga Ballkani Perëndimor. Në vijim të këtij aktiviteti, u zhvilluan vizita në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Organizatën TdH, Qendrën Multidisiplinare "Të qëndrojmë së bashku". Gjatë kësaj vizite studimore u prezantua puna që ndiqet nga secili institucion i përfshirë në parandalimin dhe luftimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe bashkëpunimi me QKEDH.

Drejtori i QKEDH me ftesë të "Strong Cities Network", mori pjesë në Samitin e katërt Global, që u zhvillua në New York City, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Shtator 2023, në prag të Sezonit të 78-të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Në vijim, Drejtori i QKEDH, me ftesë të "Strong Cities Network" mori pjesë në 2(dy) takime me temë: "Zhbllokimin e potencialit të qytetit për të kontribuar në përpjekjet e të gjithë shoqërisë në rehabilitimin dhe ri-integrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit"; "Takimi i koordinimit të rrjeteve të qytetit për paqen dhe sigurinë".

Drejtori i QKEDH, Z. Denion Meidani me ftesë të Universitetit të Kolumbisë dhe "Strong Cities Network" mori pjesë në takim me temë: Parandalim dhe përgjigje multidisiplinare ndaj urrejtjes dhe ekstremizmit.

QKEDH zhvilloi takim online me përfaqësues të Strong Cities Network dhe Inicativës Atlantike mbi mbështjetjen e QKEDH-në në studimin e tyre mbi analizimin e modeleve të bashkëpunimit kombëtar dhe lokal, për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke paraqitur eksperiencën e Shqipërisë në këtë fushë dhe arritjet e QKEDH.

Përsa i përket bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, Drejtori i QKEDH-së mori pjesë në tryezën e organizuar nga ambasadorja e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Znj. Christiane Hohmann për të kremtuar Shqipërinë dhe Evropën. Në këtë event u paraqitën disa rezultate të rëndësishme të mbështjetjes së BE për popullin shqiptar si dhe shënimin e përfundimit të mandatit të ambasadores Hohmann.

Në nivel kombëtar, në vijim të rolit të qendrës si koordinues kombëtare mbi ekstremizmin e dhunshëm:

<sup>42</sup> IOM ka siguruar mbështjetjen për 4familje të rikthyera nga ish zonat konflikti gjate tre riatdhesimeve, si dhe 5familjet e Cërrikut,





- QKEDH u thirr dhe mori pjesë në një GTN urgjencë, të organizuar nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) pranë Bashkisë Tiranë, ku u diskutua mbi një rast problematik dhe konsideruar nga PMF me element ekstremizmi. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Zyra Përmbartimore Tiranë, Drejtoria e Policisë (Komisariati Nr. 1), TLAS, Nisma ARSIS, Drejtoria e Anti-Terrorit dhe ZVA Tiranë, ku aktorët u vunë në dijeni të faktit se Gjykata e Apelit Tiranë ka nxjerr një vendim ku detyron PMF ta zbatoj. Në final u vendos me të gjithë aktorët rruga që duhet të ndiqen nga institucionet për ekzekutimin e vendimit.
- Gjatë periudhës raportuese, QKEDH u thirr dhe mori pjesë në GTN-në urgjente, të organizuar nga NJMF pranë Bashkisë Librazhd, mbi një rast problematik të konsideruar nga NJMF dhe ZVA Librazhd me element ekstremizmi, ku morën pjesë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Social, Kryetare MEDPAK, Myftiu i myftinisë Librazhd, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Parësor, Administrator Social i NjA Hotolisht, ZVA Librazhd, përfaqësues të Komisarariatit të Policisë Librazhd, Drejtori dhe psikologu i shkollës Dardhë. Në këtë takim u propozua nga Myftiu dhe drejtori i Policisë së Qarkut të Librazhdit që të vazhdohet me qasjen e butë duke i dhënë edhe pak kohe babait për ti lejuar fëmijët të shkojnë në shkollë. QKEDH po vijon koordinimin në nivel qendror mbi rastin e ekstremizmi të dhunshëm të referuar nga NJMF pranë Bashkisë Librazhd. Në vazhdim, të gjithë aktorët do të mblidhen për të rishikuar masat e vendosura në GTN dhe për hapat që ndiqen në vazhdim, si dhe organizimin e një GTN me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces për menaxhimin e këtij rasti.
- Gjithashtu, QKEDH kontribuoi nëpërmjet koordinimit të institucioneve përgjegjëse mbi një rast ekstremizmi të dhunshëm raportuar nga Oficeri i Sigurisë në një shkollë 9-vjeçare në Bashkinë Tiranë.

Mbështetja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka vijuar të jetë domethënëse për QKEDH, kjo shprehet në disa takime të mbajtura: Drejtori i QKEDH-së, zhvilloi takim prezantues me përfaqësues të Ambasadës së Amerikane në Tiranë, Z. Joseph R. Baldëin dhe Znj. Nisha Abraham: Drejtori i QKEDH dhe përfaqësues të tjerë zhvilluan takim me përfaqësues të ambasadës amerikane mbi diskutimin e projekteve në fushën P/KEDH.

QKEDH ka zhvilluar disa takime online me Grupin e Këshillimit të Projektit “PASG” mbi mbështetjen e Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në fazën e nisjes së riadhesimit të shtetasve shqiptarë dhe shtetasve të vendeve të tjera nga kampet “Al Hawl dhe Al Roj” në Siri.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional, janë zhvilluar disa takime dhe aktivitete si vijon:

Drejtori i QKEDH zhvilloi takim me përfaqësues të Drejtorisë së Anti-Terrorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku u diskutua mbi “Situata në Kampet Al-Hawl dhe Al Roj” si dhe për vijueshmërinë e programeve R&R; QKEDH zhvilloi takim me ekspertin e Këshillit të Europës Z.Alban Dafa dhe Fokus Grupet për politikën dhe koordinimin ndërinstitucional për të kryer përgatitjen për lirim dhe mbështetjen pas lirim të të burgosurve të dënuar për ekstremizëm të dhunshëm, të



radikalizuar, apo të rrezikuar për t'u radikalizuar; Gjithashtu drejtori i QKEDH-së Z. Meidani zhvilloi takim me Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Z. Admir Abrija dhe Drejtorin e Shërbimit të Provës, Z. Ervin Hoxha, ku u diskutua mbi koordinimin e përbashkët që kanë këto institucione mbi planin e veprimit të QKEDH.

QKEDH ka zhvilluar disa takime me përfaqësues të organizatës Projekte Vullnetare Ndërkombëtare (PVN Albania). Gjatë takimeve u diskutua mbi çështjet e parandalimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri si dhe mënyrën sesi mund të krijohet grupe vullnetare për të punuar në komunitet mbi këtë çështje. Në kuadër të Vlerësimit Kombëtar që po zbatohet nga Fondi Global i Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë të Komunitetit (GCERF) nëpërmjet organizatës Projekte Vullnetare Ndërkombëtare ka zhvilluar 30 intervista me aktorë të përshirë në P/CVE si dhe aktorët e vijës së parë si dhe u zhvilluan 5 fokus grupe që përfshijnë mësuesit, punonjësit e mbrojtjes së femijëve, si dhe psikologët.

QKEDH ka koordinuar me partnerët e Ballkanit Perëndimor: Kosova, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia për caktimin nga ana e tyre e një eksperti nga secili shtet, me qëllim identifikimin e modeleve positive në lidhje me legjislacionin dhe praktikën institucionale që lidhen me P/CVE, identifikimin dhe ri-integrimin e RFTF, në kuadër të projektit “Lënia e së kaluarës pas: Rritja e qëndrueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm përmes mbështetjes dhe edukimit” që do të zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkut në bashkëpunim me LKGV, mbështetur financiarisht nga GCERF.

Në kuadër të raportimeve institucionale, QKEDH mori pjesë në dy takime online për të marrë udhëzimet e fundit mbi raportimin e delegacionit shqiptar në Gjenevë përsa i përket shqyrtimit të raportit të Shqipërisë në Komitetin për të Drejtat e Fëmijës (CRC) në Gjenevë, në të cilin QKEDH mori pjesë në raportim **online** CRC.

QKEDH mori pjesë në punëtorinë e radhës të Habit Rajonal të Ballkanit Perëndimor: "Forcimi i rolit të qyteteve për adresimin e urrejtjes, ekstremizmit dhe polarizimit përmes bashkëpunimit të përmirësuar kombëtar-vendor" të organizuar nga Rrjeti i Qyteteve të Forta që u zhvillua në Budva, Mali i Zi.

Gjithashtu, QKEDH mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të ekspertëve "Përtej kufijve: Hulumtimi i ekstremizmit të djathtë në Evropën Juglindore" si pjesë e projektit: “Parandalimi i radikalizimit, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit” të organizuar nga Qendra për Kërkimet e Sigurisë dhe Drejtësisë “Iniciativa Atlantike” që u zhvillua në Podgoricë, Mali i Zi, mbi diskutimin e metodave të kërkimit, gjetjet e hulumtimeve në të djathtën ekstreme, radikalizmi online dhe nacionalizmi etnik. QKEDH mori pjesë në takimin e zhvilluar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë me grupet e fokusit në kuadër të projektit “Rritja e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor për menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe parandalimin e radikalizimit të mëtejshëm pas lirimit”.



QKEDH mori pjesë në “Seminarin Rajonal për Përmirësimin e Monitorimit të Burgjeve dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut” me fokus personat që vuajnë dënimet për veprat penale të ekstremizmit të dhunshëm dhe të terrorizmit e organizuar nga OSCE dhe Zyra për Institucione të Demokracisë dhe të Drejtave të Njeriut (ODIHR). Ky seminar ishte një nismë e rëndësishme që synon të adresojë sfidat komplekse të lidhura me parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm (VERLT) në sistemet e burgut në vendet e Evropës Juglindore me objektivi kryesor për të krijuar një platformë ku ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, monitoruesit e burgjeve dhe përfaqësuesit nga autoritetet e relevante dhe praktikantët e burgjeve mund të mblidhen për të diskutuar strategji për adresimin e shqetësimeve të të drejtave të njeriut që dalin nga përpjekjet për parandalimin e VERLT në sistemin e burgjeve.

Gjithashtu, me ftesë të Departamentit të Shtetit, Drejtori i QKEDH mori pjesë në takimin me temë “Duke mundësuar kthimin e sigurt të luftëtarëve terroristë të huaj dhe familjarëve të tyre Siria”.

Drejtori i QKEDH Z. Denion Meidani me ftesë të Qendrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare New York dhe Zyra e Antiterrorit të Kombeve të Bashkuara mori pjesë në takimin: Forcimi i bashkëpunimit global-lokal në adresimin e ekstremizmit të dhunshëm: si perspektiva dhe përvoja e udhëheqësve dhe qeverisë lokale mund të informojë punën e OKB-së.

Drejtori i QKEDH pati një takim bilateral me Z. Ian Moss, Zv/ Koordinator për terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në Departamentin e Shtetit.

Gjatë periudhës raportuese, vlen të përmenden disa takime të zhvilluar online për fushën P/KEDH: QKEDH mori pjesë në takimin online me Grupin Koordinator të Anti-terrorit të Kombeve të Bashkuara; në takimin online me Amnesty International, London; në takimin me Zyrën e ECBE për programin “Post Penal” në burgje.

Gjatë periudhës raportuese, QKEDH mori pjesë në vizitën studimore të Komisionit Evropian të mbajtur në Milano, Itali me temë “Midis komunikimit strategjik dhe urrejtjes, ku u mbajt fjalimi “Përdorimi dhe ndikimi i analizës së mediave sociale”, me ftesë të Organizatës RAN Policy Support për Ballkanin Perëndimor.

Përfaqësues të QKEDH patën një takim me znj. Valerie Silensky, Koorditore e Burosë dhe Marrëdhënieve Evropiane, Zyrës së Politikave dhe Iniciativave Globale të Kundër terrorizmit pranë Departamentit të Shtetit. Qëllimi i kësaj vizite ishte prezantimi i znj. Silensky me punën e qendrës si dhe njohjen e politikave mbi P/CVE në Ballkanin Perëndimor dhe mënyrat e bashkëpunimit të mëtejshëm me QKEDH.

Në kuadër të raportimit mbi zbatimin e masave të Planit të Veprimit 2023-2025 të Strategjisë Ndërsëktoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-



2025, QKEDH organizoi takim ndërinstitucional shpjegues me të gjithë personat përgjegjës që do të raportojnë masat përgjegjëse për çdo institucion.

QKEDH mori pjesën në webinar e zhvilluar nga Radicalization Awareness Network: 2,5 vite të RAN në Ballkanin Perëndimor, mësimet e nxjerra dhe sfidat që do vinë.

Gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2023, QKEDH zhvilloi takim me organizatën GADC e cila është pjesë e konkursiumit me GCERF për zbatimin e projektit “Forcimi i qëndrueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm përmes mbështetjes dhe edukimit”. Në këtë takim u diskutua mbi realizimin e disa masa të Planit të Veprimit 2023-2025 mbi fuqizimin e grave të rikthyera nëpërmjet krijimit të mundësive dhe mbështetjes së punësimit të tyre.

Drejtori i QKEDH, Z. Meidani mori pjesë dhe kontribuoi në konferencën e radhës të Rrjetit Rajonal të Koordinatorëve Kombëtarë CT/CVE (RNCC) të Ballkanit Perëndimor me ftesë të Këshilltarit Rajonal kundër terrorizmit dhe Sigurisë EUD Sarajevë, të mbajtur në Shkup. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe në Shkup, Z. Meidani zhvilloi takim me Komitetin Drejtues Rajonal të Projektit Rajonal të financuar nga BE për RRR, zbatuar nga IOM; si dhe një takim me Komitetin Drejtues të projektit për veprimet penitenciare dhe rehabilitimin e VEP-ve të Këshillit të Evropës.

QKEDH mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga OSBE në Vjenë, ku morën pjesë anëtarë nga Rrjeti Profesionist i Grave në P/CVERLT, nga Azia Qendrore dhe Evropa Juglindore. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte forcimi i Rrjetit Profesionist të Grave në P/CVERLT, vlerësimi i projekteve të ndërmarra nga ky rrjet si dhe përcaktimi i projekteve dhe sfidave në të ardhmen.

QKEDH mori pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të projektit të bashkëpunimit ballkanik “Për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe hapësirave publike”, i cili u mbajt në Shkup, Maqedoni e Veriut.

QKEDH zhvilloi një takim me drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Tiranë dhe organizatën GADC<sup>43</sup> në kuadër të proceseve të rehabilitimit dhe ri integritit mbi fuqizimin ekonomik të grave të rikthyera.

Në kuadër të aktivitetit “Përfshirja e palëve të interesuara me bazë fetare në P/KEDH dhe RRR”, si dhe në kuadër të bashkëpunimit me Komitetin Ndërkombëtar Fetar të Shqipërisë, QKEDH zhvilloi një sesion prezantimi mbi aktivitete dhe punën e qendrës ku pjesë ishin përfaqësues të komuniteteve fetare dhe përfaqësues të qeverisë së Maqedonisë së Veriut.

QKEDH zhvilloi një takim me agjencinë AIDA ku u diskutua mbi proceset RRR dhe fuqizimin ekonomik të grave. Gjithashtu, në takim u shpjegua nga QKEDH procesi i raportimit të kësaj agjencie

---

<sup>43</sup> Gender Alliance for Development Centre (GADC) e cila është pjesë e konkursiumit me GCERF për zbatimin e projektit “Forcimi i qëndrueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm përmes mbështetjes dhe edukimit”.



mbi Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025.

Në vijim, QKEDH koordinoi dhe mori pjesë në takimin e drejtuar nga zv. Ministria e Brendshme me përfaqësues nga GCERF dhe grupit ndërinstitucional teknik të mekanizmit të mbështetjes së projekteve. Në këtë takim u prezantua Strategjia e Investimit për periudhën 2022-2027, e cila synon të adresojë sfidat e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në shoqërinë tonë. Në takim ishin të pranishëm përfaqësues të GCERF, delegacionit të BE në Shqipëri, përfaqësues të Ambasadës së Vendeve të Ulëta si dhe përfaqësues të institucioneve të përfshira në përpjekjet për P/KEDH si dhe shoqërisë civile, të cilët diskutuan strategjinë dhe rolin e tyre në zbatimin e saj. Strategjia përfshin një qasje gjithëpërfshirëse dhe multisfere, duke angazhuar jo vetëm institucionet qeveritare por edhe shoqërinë civile, me qëllim koordinimin e përpjekjeve dhe forcimin e kapaciteteve për të luftuar këto fenomene sociale.

Përfaqësuesit e QKEDH morën pjesë në vizitën studimore me temë: "Parandalimi dhe kundërshtimi i ekstremizmit të dhunshëm në burgje", e mbajtur në Romë, Itali me ftese nga EuroPris- Organizata Evropiane e Burgjeve dhe Shërbimeve Korrektuese.

QKEDH zhvilloi takim me Znj. Nona de Jonge, Koordinatore Rajonale e Sigurisë për Ballkanin Perëndimor në Ambasadën e Vendeve të Ulëta ku u bë një prezantim i QKEDH-së, arritjet dhe sfidat, si dhe u dakordësua për zhvillimin e marrëdhënieve dhe projekteve të mëtejshme me këtë ambasadë në fushën P/CVE.

Në kuadër të bashkëpunimit me ambasadat e huaja; Drejtori i QKEDH zhvilloi takim me ambasadorin gjerman me qëllim rritjen e bashkëpunimit në fushën e parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm; QKEDH zhvilloi takim me Znj. Nona de Jonge, Koordinatore Rajonale e Sigurisë për Ballkanin Perëndimor në Ambasadën e Vendeve të Ulëta ku u bë një prezantim i QKEDH-së, arritjet dhe sfidat, si dhe u dakordësua për zhvillimin e marrëdhënieve dhe projekteve të mëtejshme me këtë ambasadë në fushën P/CVE.

Përgjatë periudhës raportuese, përfaqësues të QKEDH-së morën pjesë dhe kontribuan në takimin e parë të Grupit të Punës për Zhvillimin e programit të përgatitjes për lirim për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm, të burgosurit vulnerabël dhe të marginalizuar në rrezik nga radikalizimi. Aktiviteti u zbatua në kuadër të veprimit rajonal të Këshillit të Evropës "Rritja e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor në menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe parandalimi i radikalizimit të mëtejshëm pas lirim".

Drejtori i QKEDH, z. Denion Meidani, në cilësinë e anëtarit të bordit dhe me ftesë të kryetarit të Bordit të Fondit të Angazhimit dhe të Qëndrueshmërisë së Komunitetit Global (GCERF), mori pjesë në Mbledhjen e 19 të Bordit të GCERF, e cila u mbajt në Gjenevë, Zvicër. Gjatë kësaj mbledhje, Bordi Drejtues i GCERF ka miratuar strategjinë e GCERF-it për investimet në Shqipëri; QKEDH përcolli



këtë strategji pranë të gjithë institucioneve dhe donatorëve pjesëmarrës në Mekanizmin e Mbështetjes Teknike.

QKEDH mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në sistemin e drejtësisë penale dhe më gjerë: Gjetjet dhe hapat e ardhshëm drejt praktikave të qëndrueshme në Ballkan, Evropën Jugore dhe Lindore” e cila shënoi Konferencën Përfundimtare të Projektit HOPE, të organizuar nga Veprimi Rajonal i Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor, në bashkëpunim me Koordinatorin e Konsorciumit të Projektit HOPE IPS\_ Sisteme Inovative të Burgjeve që u zhvillua në Lisbonë, Portugali.

QKEDH mori pjesë në takimin e organizuar online me përfaqësues të Antiterrorit të Ministrisë së Jashtme të Hollandës me temë: Rritja e bashkëpunimit dypalësh në fushën e KEDH.

Në kuadër të bashkëpunimit me ambasadat e huaja, Drejtori i QKEDH zhvilloi takim me ambasadorin gjerman me qëllim rritjen e bashkëpunimit në fushën e parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Drejtori i QKEDH zhvilloi takim me drejtuesit e EU4LEA – European Union for Law Enforcement in Albania mbi mundësitë e bashkëpunimit me EU4LEA për çështjet KEDH për vitin 2024.

QKEDH mori pjesë në takimin e zhvilluar me IOM mbi implementimin e donacionit të sistemit të bazës së të dhënave për menaxhimin e informacionit (sistemi ICRS), databazë elektronike për personat e kthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak.

Në kuadër të bashkëpunimit me palë të treta, QKEDH zhvilloi takim me organizatën TdH mbi projektin<sup>44</sup> që po zhvillon në vijim të proceseve R&R&R me mbështetjen financiare GCERF.

Përsa i përket bashkëpunimit me komitetet fetare, QKEDH përcolli për vlerësim pranë Komitetit Mysliman Shqiptar një botim<sup>45</sup> të referuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim, i cili ka si qëllim ndërgjegjësimin e personave që trajtohen në sistemin e burgjeve dhe shërbimit të provës, i cili me pas do të shpërndahet në këto institucione.

QKEDH zhvilloi takim online me “The National Reintegration Center of the Maldives (NRC) mbi zhvillimin e një vizite studimore në Shqipëri me qëllim marrjen e praktikës dhe shkëmbimin e eksperiencave në lidhje me implementimin e proceseve R&R&R të zhvilluara nga QKEDH.

**Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, QKEDH zhvilloi disa takime me përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë për diskutimin e çështjes së riatdhesimit të shtetasve shqiptar nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak.**

<sup>44</sup> Parandalimi dhe riintegrimi i sigurt: Qasje holistike dhe e qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm

<sup>45</sup> Botimi me titull “Një mysliman përballë terrorizmit” me autor Behaaddin E. Gashi.





Në vijim të marrëdhënieve me organizatat, QKEDH zhvilloi takim online me Hedayea dhe Zyra e Antiterrorit të Kombeve të Bashkuara mbi diskutim mbi mundësitë e mbështetjes së QKEDH në fushën e komunikimit strategjik për kundërshtimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

QKEDH mori pjesë në ceremoninë e zhvilluar në kuadër të 30 vjetorit të IOM në Shqipëri në kuadër të mbështetjes që ka dhënë kjo organizatë mbi proceset e riintegritimit dhe mngitjes së kapaciteteve të stafit të QKEDH.

QKEDH koordinoi dhe zhvilloi takim me organizatat e shoqërisë civile për vijimësinë e mbështetjes së proceseve të ri integritimit të familjeve të kthyer nga zonat e konfliktit.

## **8. AKTIVITETI RAPORTUES DHE MONITORUES**

### **1. PROBLEMATIKA**

Përgjatë kësaj periudhe raportimi, QKEDH evidenton si problematika të rëndësishme që kërkojnë vëmendjen e Ministrisë së Brendshme për adresim institucional si më poshtë:

- Rritja e mëtejshme e kapaciteteve profesionale për të gjitha strukturat e kategorizuara në të ashtuquajturën “qasje e butë”, por jo vetëm, që do të angazhohet në riadhesimin e shtetasve shqiptarë që ndodhen aktualisht në ish zonat e konfliktit, Siri dhe Irak. Të gjitha programet e riintegritimit për këtë kategori, përfshirë gratë/vajzat dhe fëmijët, kërkojnë angazhim të vazhdueshëm dhe afatgjatë të burimeve financiare dhe njerëzore në terren. Aktualisht, këto burime mbeten ende të kufizuara.
- QKEDH në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit synon të ndërhyjë në kurrikulën bazë arsimore për ta pasuruar atë në kuadrin e njohurive arsimore të përgjithshme të nxënësve shqiptarë duke iu referuar konceptit bazë. Nga ana tjetër, po zhvillohet një proces aktiviteti për krijimin e platformave të edukimit digjital, ku veçanërisht të rinjtë mund të shkëmbejnë ide dhe të ndërtojnë narrativa alternative efektive për t’iu kundërvënë këtij fenomeni, një qasje e cila do të kontribuojë në zhvillimin e të menduarit kritik për çështje të tilla si demokracia, feja, të drejtat dhe liritë e individit etj.
- Dukuria e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në vendin tonë kërkon një “qasje shumë dimensionale” dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve qendrorë dhe vendorë në zbatimin e kuadrit ligjor strategjik në fuqi, me qëllim parandalimin dhe zhvillimin e alternativave të qëndrueshme. Për këtë arsye, është shumë e domosdoshme ndjekja e procedurave respektive për miratimin e urdherit të Kryeministrit “Për krijimin e komitetit rajonal të parandalimit të radikalizmit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm”.
- Duke marrë në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga marreveshja “Joint Action Plan on Counter-Terrorism for Eastern Balkans” ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit të EU



fimosur nga Ministri Çuçi dhe Komisioneri Johansson më datë 09.12.2022, konkretisht, pika 1.1 (a), pika 1.2 (c), dhe rekomandimet e misionit të “EU Peer Review Mission” i shtatorit 2022, ku Shqipëria merr përsipër zbatimin e rekomandimeve për ngritjen e një sistemi Vlerësimi Kombëtar i Kërcënimeve; zhvillimin e një qasje të strukturuar të “Vlerësimi dhe Analizës së Përbashkët të pavarur të Informacionit”; Krijimi i Qendrës “Fusion Center” të Shkrirjes së Informacionit; “Zhvillimi i një sistemi të përbashkët kombëtar të klasifikimit të kërcënimeve”; QKEDH ka propozuar Ministrisë së Brendshme projekt propozimin për krijimin e “Agjencisë Kundër Terrorizimit dhe Ektremizmit” e parashikuar për tu miratuar në katër mujorin e parë të këtij viti në bazë të VKM 862 datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023, edhe përse janë kryer një sërë takimesh për këtë qëllim, akoma mbetemi në pikën fillestare të propozimit nga QKEDH.

- Që prej vitit të kaluar, QKEDH ka konstatuar se institucioni ka mangësi të rëndësishme në librat e inventarit të aseteve, konkretisht të aseteve donacione nga organizata të ndryshme. Për zgjidhjen e këtij shqetësimi, është koordinuar me Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve të MB, për të cilën është ngritur një grup pune nën drejtimin e kësaj të fundit për evidentimin, dokumentimin dhe përfundimin e inventarit të aseteve për të cilën, QKEDH vazhdon të jetë në pritje të përmbylljes së saj nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve pranë MB.

Gjatë periudhës raportuese është theksuar angazhimi i QKEDH, për pasojë raportohen disa nevoja urgjente të cilat duhet të adresohen në periudhën e ardhshme raportuese në nivel kapaciteti institucional dhe veprimi në të gjitha fushat ku operon QKEDH, dhe më konkretisht:

1. Nevojë urgjente për miratimin e propozimit të QKEDH për krijimin e “Agjencisë Kundër Terrorizimit dhe Ektremizmit” dhe rritjen e numrit të punonjësve nisur nga fusha e veprimtarisë dhe përgjegjësisë së QKEDH pasi organika aktuale 1+7 e cila ka sjellë mbingarkesë për të gjithë punonjësit e QKEDH duke kryer më shumë se dy detyra funksionale në të njëjtën kohë.
2. Nevoja urgjente e një mjeti transporti nisur nga angazhimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe gjendja aktuale e mjeteve të QKEDH në dispozicion ku nga tre mjete në inventar vetëm një mjet është në gjendje funksionale aktualisht.
3. Nevojë urgjente për ambiente pune (zyra) pasi zyrat aktuale të vendoru përkohësisht pranë Ministrisë së Brendshme, akoma nuk janë me një status të qartë qëndrimi për QKEDH dhe që nuk plotëson kushtet e sigurisë së kartotekës dhe kompjuterave për prodhimin e dokumentacionit të klasifikuar.
4. Prioritizim i miratimit të Urdhrit të Kryeministrit për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm i cili do të shërbejë si mekanizëm kombëtar referimi, pasi një mekanizëm i tillë mungon duke sjellë vështirësi dhe pamundësi të evidentimit të rasteve dhe fenomeneve në kohë me qëllim adresimin e tyre.





5. Për zbatimin e masave dhe ndjekjen e detyrimeve respektive sipas institucioneve të përfshira në zbatim të “Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2023-2025)” dhe planet përkatëse të veprimit, QKEDH ka përcjellë pranë Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme kërkesën për ndërhyrje institucionale, për caktim të pikave të kontaktit të institucioneve përgjegjëse me urdhër titullari, për raportimin dhe ndjekjen e detyrimeve institucionale për të cilën ende nuk kemi përgjigje.